



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK KORÇË**

VENDIM

Nr. 154, datë 29.12.2021

PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL "SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË"

Në mbështetje të Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social, nenin 47, 15,pikat 1,2, 3 , të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", "VKM 384, datë 12.06.2019,"Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore" VKM nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" dhe V.K.B. nr.6 datë 30.01.2020 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit, "Subvencioni i interesave të kredisë", bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit dhe M.B.S , Këshilli Bashkiak Korçë,

VENDOSI:

- 1.Miratimin e 13 (trembëdhjetë) familjeve të cilat përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i interesave të kredisë ", sipas listës bashkangjitur .
2. Familjet e përcaktuara në listën fituese, të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucioneve Bankare si: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa Sanpaolo, nga momenti i njoftimit që kryen Bashkia Korçë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet e Drejtoria e Strehimit dhe Menaxhimit të Banesave Sociale .
4. Ky vendim hyn në fuqi 10-ditë pas shpalljes.

**Kryetari Këshillit Bashkiak
Erjon NEXHIPI**

